



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-15-0061-A0002**

**A-0002-Sh.K.**

**Paditësit/Ankuesit**

**R.K.**

**I.K.**

**A.M.**

**Sh.J.**

**D.C.**

**Përfaqësuar nga av. E.G.**

**Kundër:**

**E paditura/Ankuesja**

**A-0001- KBI , Prizren NSH " LB",**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve të parashtruar kundër Aktgjyimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-13-0483, të datës 10 mars 2015 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12/09/2019, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1.** Ankesat e ankuesve, A0001-AKP-së dhe A0002 1. Sh.K. , 2.R.K. , 3.I.K. , 4.A.M., 5.Sh.J., 6. D.C. , refuzohen si të pa bazuara.
- 2.** Vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-III-13-0483, i datës 10 mars 2015.
- 3.** Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike**

Me dt. 24.10.1994 Zyra e prokurorit publik komunal në Prizren kishte ngrit padi me të cilën kërkoi anulimin e Kontratës mbi Dhuratën Nr. 406/1966, e vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Prizren me dt. 09.04.1966, e lidhur në mes të KBI , Prizren NSH " LB", D dhe F.K.si dhe dorëzimin në posedim të kësaj patundshmërie.

Me 15.12.1997 Gjykatës Komunale në Prizren nxori Aktgjykimin P. Nr. 938/94 me të cilin ishte aprovuar, kërkesa e Prokurorit Publik Komunal në Prizren dhe vërtetohet se është nulë Kontrata mbi Dhuratën e Paluajtshmërisë Nr. 406/66, e vërtetuar nga ish Gjykata Komunale në Prizren me dt. 09.04.1966, e lidhur në mes të palëve të lartcekura.

Duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktgjykimin C. Nr. 141/98 të dt. 26.03.1998, kishte refuzuar ankesën e të paditurës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e ankimuar.

Paditësi me dt. 04.06.1998 ka dorëzuar padin në Gjykatën Komunale në Prizren kundër të paditurës me kërkesë për dorëzim, kompensim të patundshmërisë, të ngastrës kadastrale si në pikën -I- të dispozitivit të Aktgjykimit të formës së prerë nr. 938/94 të datës 15/12/1997, gjegjësisht një pjesë nga ngastrën kadastrale nr. 6619/1 vendi i quajtur Pashali në sipërfaqe prej 0.21,21 ndërsa për sipërfaqen tjetër, ngastra kadastrale 1619/2 e cila tashmë evidentohet në emër të personit

privat në sipërfaqe prej 2971 m<sup>2</sup>, kërkon kompensim me pronë tjetër bujqësore të bonitetit të njëjtë apo kompensim me të holla.

Me dt. 30.01.2012 ish Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C.nr. 548/98, shpallet in kompetente për të vendosur lidhur me padinë dhe vendos që lënda ti dërgohet Dhomës së Posaçme.

Me dt. 15.03.2012 Dhoma e Posaçme ka pranuar lëndën C.Nr. 548/98 të dërguar nga Gjykata Komunale e Prizrenit.

DHPGJS me Aktvendimin, C-III-12-0400 të datës 29 mars 2013 ka vendosur që nuk ka juridiksion mbi padinë e ushtruar nga paditësit dhe dosja e lëndës i është kthyer Gjykatës Komunale në Prizren.

Gjykata Themelore në Prizren, më datë 17 qershor 2013 me parashtresë i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën ka kërkuar që të zgjidhet konflikti i kompetencës lëndore lidhur me lëndën në mes DHPGJS dhe Gjykatës Themelore në Prizren.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin e datës 10 korrik 2013 ka vendosur që për të gjykuar në këtë çështje juridike civile kompetente është DHPGJS, ngase nuk kemi të bëjmë me përmbarrimin e Aktgjykimit të ish Gjykatës Komunale ashtu sic pretendon DHP, ngase në Aktgjykimin e cekur vetëm është anuluar Kontrata mbi Dhurimin e patundshmërisë. Lënda evidentohet si C-III-13-0483.

Paditësit parashtrojnë Aktvendimin e Trashëgimisë T.nr. 354/09 të datës 22/08/2014 sipas të cilit trashëgimtarë të Feta K janë: Sh.K. ,R.K. , A.M., e lindur K , Sh.J. , e lindur K dhe D.C. e lindur K .

DHPGJS-ja përmes urdhrit të datës 30 janar 2014 i ka dërguar padinë së bashku me dokumentet përcjellëse palës së paditur-AKP-së

AKP-ja me 28 shkurt 2014 ka parashtruar mbrojtje në padi duke pohuar se padia nuk përmban elementet e nenit 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit 04/L-0033. Çështja e ngritur nga paditësi i takon sferës së procedurës përmbarrimore për faktin se në

rastin konkret kemi të bëjmë me padi për dorëzimin e patundshmërisë. Po ashtu thekson se çështja në fjalë është res judicata për shkak të Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe se kërkesa është parashkruar, duke propozuar që të aprovohet mbrojtja e AKP-së si e bazuar dhe të refuzohet padia e paditësve si e pa bazuar në ligj.

Paditësi me 02 prill 2014 ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së, duke pohuar se përgjigja në padi është e pa bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

DHPGJS lidhur me këtë çështje ka mbajtur seancë dëgjimore.

Më 10 mars 2015 Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme kishte marrë a Aktgjykim, C-III-13-0483 me të cilin:

Padia e paditësve aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe paditësve: Sh.K. , R.K. , I.K. , A.M., Sh.J. dhe D.C. , i njihet e drejta pronësore në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 6619/1 në sipërfaqe prej 021,21 ha, në vendin e quajtur "Pashalti", me kulturë arë, nga fleta poseduese nr. 7417, Zk Prizren dhe e njëjta regjistrohet në Librin Kadastral, të cilën gjë i padituri nuk duhet ta pengojë, me arsyetimin se për pjesën e ngastrës kadastrale 6619/1 paditësit kanë një titull pronësor dhe kanë bazë ligjore ti kthehet toka e cila është objekt i kontratës së anuluar.

Refuzohet, kërkesë padia si e pa bazuar lidhur me ngastrën kadastrale 6919/2 nga fleta poseduese 8417, ZK Prizren, në sipërfaqe prej 2971 m<sup>2</sup>, ZK e cila aktualisht është në emër të personit fizik, Q.C. , me arsyetimin se e njëjta nuk është në pronësi të të paditurit. Ajo është tjetërsuar tek pala e tretë në fillim tek Industria Sintetike "PX" përmes ujdisë gjyqësore nr. 1233/91 të datës 01.07.1992 e më pastaj kjo ngastër ka kaluar tek personi fizik Q.C.

Më 07 prill 2015,e paditura AKP-ja, (më tutje Ankuesi i parë) ka parashtruar ankesë kundër pikës -I- të dispozitivit të Aktgjykimit, C-III-13-0483 të datës 10 mars 2015 ( më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesi i parë pohon se aktgjykimi i Gjykatës Komunale P.br. 938/94 i datës 15.12.1997

me anë të së cilit është anuluar kontrata e shitblerjes POSL.OV.Br.406/66 nuk paraqet bazë ligjore për fitimin e pronësisë, për faktin se aktgjykimi në fjalë ka karakter deklarativ dhe asesi nuk ka konstituar një të drejtë, po ashtu në kuptim të nenit 379 të LMD-së është parashkruar pasi që kanë kaluar 14 vite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit të sipërcituar prandaj kërkesa është parashkruar , sipas ankueses aktgjykimi i atakuar paraqet shkelje të parimeve të drejtësisë për faktin se çështja në fjalë është res judicata dhe njëkohësisht është në kundërshtim me parimin Ne Bis in Idem. Gjithashtu nuk është vendosur lidhur me çështjen e kthimit të presitimeve gjë që mundëson pasurimin pa bazë të njërës palë. Kolegjit të Apelit të Dhomës se Posaçme i propozon që ankesa të aprovohet, të anulohet pika e -I- e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe të refuzohet padia si e pa bazuar.

Më 08 prill 2015, paditësi ( më tutje ankuesi i dytë), përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. E.G. ka parashtruar ankesë kundër pikës -II- të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konsatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesi i dytë pohon se si ka qenë e mundur që parcela 6619/2, fleta poseduese 8417 ZK Prizren, në sipërfaqe prej 2971 m2 në fillim të ketë kaluar tek Industria sintetike PX e pastaj tek personi i tretë Q.Q. parcela kontestuese asnjëherë nuk ka qenë në shfrytëzim pronësi të dikujt tjetër përveç paditësit dhe se personi fizik me emrin Q.Q. në çfarë bazë është bërë pronar ne letër ndërsa asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar dhe as nuk e shfrytëzon parcelën kontestuese. Dhomës se Posaçme i propozon që ankesa e tij të aprovohet dhe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet në favor të pretendimeve ankimore ose i njëjti të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesat e ankuesve A0001 dhe A0002, refuzohen si të pa bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit , Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Vlerësimet e kolegjit të Apelit lidhur me ankesën e AKP-së**

Paditësit me padi kërkojnë nga Gjykata, vërtetimin e së drejtës pronësore në patundshmëritë nga Aktgjykimi i formës së prerë nr. 938/94 të datës 15/12/1997. Sipas të cilit Kontrata mbi Dhuratën Nr. 406/1966, e vërtetuar në ish Gjykatën Komunale në Prizren me dt. 09.04.1966, e lidhur në mes të KBI , Prizren NSH " LB", D dhe F.K.

Kolegji i Apelit ka shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të paditurës, Aktgjykimin e ankimuar dhe të gjitha provat e prezantuara nga e paditura në këtë procedurë dhe gjeti se ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Apelit gjeti se paditësit kanë një titull pronësor të vlefshëm , Aktgjykimi i i Gjykatës Komunale Prizren nr. 938/94 të datës 15/12/1997 i vërtetuar nga Gjykata e Qarkut me Aktgjykim C. Nr 141/98 të dt. 26.03.1998.Vendimet e Gjykatës së shkallës së dytë janë përfundimtare dhe nuk mund të atakohen me mjete të rregullta Juridike . Për më tepë Kolegji i Apelit nuk gjeti asnjë thënie apo shkresë në dosje që mund të konsiderohet se ky Aktgjykim është kundërshtuar. Prandaj konsideron se Aktgjykim është i formës së prerë.

Paditësit kanë një titull Juridik, që mund të konsiderohet bazë e mjaftueshme ligjore me të cilët përkufizohet e drejta pronësore e paditësve por që kjo e drejta e tyre pronësore e cila nuk është regjistruar asnjëherë në librat publik kadastral duhet të regjistrohet në emër të tyre.

Kolegji i Apelit konsideron se të gjitha pretendimet e të paditurës lidhur me, pasurimin e pa bazë të paditësve me arsyetim se nuk janë kthyer të hollat por

vetëm prona janë të pa baza sepse për shkak të Aktgjykimit të plotfuqishëm, Kolegji i Apelit nuk mund të vendosi në meritat e tij.

Gjithashtu Kolegji i Apelit konsideron se konstatimet e Kolegjit të Specializuar lidhur me kundërshtimet e AKP-së se çështja është res judicata dhe se me një Aktgjykim të ri shkelet parimi Ne Bis In Idem janë të sakta. Me Aktgjykim ishte anuluar Kontrata mbi Dhurimin, ndërsa me padi paditësit kërkojnë dorëzimin në posedim dmth. Regjistrimin e pronës në librat kadastral. Sa i përket kalimit të kohës prej 14 vitesh nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit, Kolegji i Apelit konsideron se nuk kemi të bëjmë me parashkrim për shkak se titujt pronësor nuk parashkruhen.

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit të parë, janë të pa themelta dhe vlerëson se Kolegji i Specializuar pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë Aktgjykim të drejtë sa i përket pikës –I- të dipozitivit.

### **Vlerësimet e Kolegjit të Apelit lidhur me ankesën e paditësve**

Sa i përket pretendimeve ankimore të palës paditëse lidhur me piken e II të dispozitivit të aktgjykimit, Kolegji i Specializuar ka konstatuar se kjo ngastër është në emër të personit fizik.

Kolegji i Apelit i vlerëson si të sakta përfundimet, gjetjet faktike dhe arsyetimet ligjore të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë pjesë të aktgjykimit të ankimuar. Kolegji i Apelit konsideron se paditësit kanë parashtruar kërkesë alternative, kompensim me tokë tjetër. Është e qartë për Kolegjin e Ankesave se kërkesëpadia alternative është kompensimin tokë për tokë – një parcelë në vend të asaj që ishte në emër të të ndjerit, paraardhësi i paditësve. Një mjet i tillë nuk ekziston si çështje ligjore – një kompensim që mund të jepet në procedurën kontestimore, çdoherë është monetare. Kërkesa për kompensimin tokë për tokë që bie nën dispozitën e nenit 9.5 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit është e pa bazuar. Për më tepër nuk mund të fajësohet as NSH dhe as

AKP-ja për neglizhencën e treguar nga vetë paditësi pse një pjesë e pronës së kërkuar tashmë ka kaluar në emër të personit privat

Megjithatë, në rast të pamundësisë për të kompensuar me tokë paditësit mund të kërkojnë kompensim monetarë. Një mundësi e tillë ekziston bazuar në Ligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Padia për kompensimin monetarë bie nën dispozitën e nenit 10 të këtij Ligji dhe mund të iniciohet në DHPGJS.

Duke bazuar në këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësve duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore:**

Ankuesit nuk ngarkohen me taksë gjyqësore . Ata tashmë kanë paguar AKP-ja më 18/05/2015 ndërsa ankuesit e dytë taksën gjyqësore e pagoi më 05/07/2018.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së më 12/09/2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_

**URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT**



Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Paditësit/Ankuesit
- Tek e paditura
- Kolegjit të Specializuar në lëndën C-III-13-0483.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_